



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 10/12/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21/11/2020, të parashtruar nga i Operatori Ekonomik IMPACT SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Instalimi i kamerave në disa Institucione edukative arsimore”**, me Nr. të Prok: **613-20-6340-52-2-1** nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik IMPACT SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Instalimi i kamerave në disa Institucione edukative arsimore”**, me Nr. të Prok: **613-20-6340-52-2-1** dhe nr të breshëm 613-20-145-521, e datës 21/11/2020 kundër *Vendimit të Autoritetit Kontraktues*, të datës 18/11/2020 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

1. **Anulohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë**, OE AFA ING-Suharek : të publikuar me datë: 18/11/2020 dhe lënda kthehet në Rivlersim;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorit Ekonomik IMPACT SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Instalimi i kamerave në disa Institucione edukative arsimore”**, me Nr. të Prok: **613-20-6340-5-2-1** dhe numer të breshëm **613-20-145-521** më datë 21/11/2020 për **shpërblim me kontratë**, operatorin ekonomik AFA ING-Suharek, të datës 18/11/2020 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.
Autoriteti Kontraktues, me datë 10/12/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim në si autoritet kontraktues kemi konstatuar se pretendimet e ankuesit janë pjesërisht të bazuara

Pretendimi i parë, tenderuesi i shpërblyer me kontratë nuk ka ofruar kataloga konform kërkesave të dosjes edhe atë tek produkti bazik i aktivitetit pozicioni 2. Kamer për përdorim të jashtëm: në specifikim teknik është kërkuar që kamera të ketë: - Min. Illumination Color: 0.003 Lux@(F1.2, AGC ON), 0 Lux with IR Frame Rate TVI: 2 MP@25fps, 2 MP@30fps, 4 MP@25fps, 4 MP@30fps, 5



MP@20fps Operator fitues ka ofruar kamerë me këto përforma: - Min. Illumination Color: 0.01 Lux @ (F1.2, AGC ON), 0 Lux with IR Shutter Time PAL: 1/25 s to 1/50, 000 s NTSC: 1/30 s to 1/50, 000 s Lens 3.6 mm, 6 mm, 8 mm, 12 mm fixed le që dmth.. ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi i 2-të tenderuesi i shperblyer me kontrat ka bërë edhe shkelje të ligjit të prokurimit konkretisht ligjin për çmime abnormalisht të ulta dhe asesi të justifikuara duke ofruar këto çmime për keto produkte.

Ky pretendim nuk qëndron për arsye se çmimi i përgjithshëm ka qenë çmimi më i lirë dhe në bazë të rregullave të caktuara nga KRPP dhe Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 nuk mund të themi se çmimet e ofruara janë çmime jo normalisht të ulta, çmimet njësi që janë përmendur në kërkesen për rishqyrtim ndoshta janë jo normalisht të ulta por operatori i propozuar për shperblim me kontratë në disa pozicione ka çmime me te larta kështu që çmimi i përgjithshëm nuk është çmimin jo normalisht i ulët dhe për këtë ky pretendim është i pa bazë,

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Adem Duriqi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

